



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës
(Furnizim Vendosje)**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
42122000-0 - Pompa, 45210000-2 - Punime ndërtimi,**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 154,687,373.00 (njëqind e pesëdhjetë e katër milion e
gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

**VLERA E FONDIT LIMIT NË EURO: 1,599,001.17 (një milion e pesëqind e
nëntëdhjetë e nëntë mijë e një .17) Euro pa TVSH**

*Shënim: Konvertimi i monedhës Lekë në Euro është bërë sipas kursit zyrtar të bankës së
Shqipërisë Datë 15.10.2025 ku 1 Euro këmbëhet me 96.74Lekë.*

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"*, Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarres te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik,çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik,çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter eshte percaktuar bazuar ne ligjinnr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokuriminpublik”, neni 76 per kriteret detyruese per skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit

Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

Për punimet punimet në ndërtim :

- **NP-1 A** Punime gjurmimi në tokë
- **NP-3 B** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- **NP-6 A** Diga dhe tunele hidroteknike
- **NP-7 B** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- **NP-9 A** Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
- **NP – 11 A** Ndertime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve, linje e TN e të mesme dhe shpërndarja e energjisë .
- **NP-12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- **NS-14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni tv etj.
- **NS-18 A** Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në liçencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria	Pershkrimi i kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Referuar kapitullit të germimeve sipas parashikimit të projekt preventivit prishje/gërmime/transport/mbushje (punime për prita, gërmime shkarkimi, mbushje, transport mbeturinash). Për këtë arsye kërkohet licenca NP-1A për të garantuar që operatori ka kapacitetin teknik dhe përvojën për punime të tokës.	A	0-20 milion
NP-3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Punime për ndërtësën e hidrovorit dhe kabinën elektrike: suvatime, ndërrim dritarësh, dyerësh, veshje, lysterje, punime plotësuese dhe pajisje.	B	21-50 milion
NP-6	Diga dhe tunele hidroteknike	Referuar zërave të preventivit për Punime betoni e hekuri për pllaka, pila, mure mbajtëse, porta, zgarë filtrimi, pllaka të themelit	A	0-20 milion
NP-7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	Referuar zërave të preventivit për Punime për montim pompash, tubacione dergimi, flanaxha, lidhje hidraulike, vaskat hyrëse dhe dalje të ujit.	B	21-50 milion
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Referuar zërave të preventivit të punimeve, që përfshijnë sistemimet hidraulike në veper.	A	0-20 milion
NP-11	Ndërtime për n/stacione, kabina transformatorësh, linja të TN dhe shpërndarje energjie	Punime për vendosje transformatorësh, panele TM/TU, kabina elektrike, lidhje kabllore fuqie 20/0.4 kV, ndriçim i godinës	A	0-20 milion

NP- 12A	Punime të inxhinierisë mjedisore	Referuar punimeve të inxhinierise se mjedisit, Punime sistemimi të jashtme, mbjellje pemësh dekorative, rehabilitim mjedisor përreth hidrovorit	A	0-20 milion
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Referuar zërave të preventivit për Prishje e mureve betoni, mureve ekzistuese, heqje e elementeve të dëmtuara para rikonstruksionit	A	0-20 milion
NS-12	Impiante teknologjike, termike dhe kondicionimi	Referuar zërave të preventivit të për montimi, mirëmbajtje, ristrukturimi i një sistemi të plotë godinës dhe pompave të Hidrovorit.	A	0-20 milion
NS-14	Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj	Referuar zërave të preventivit për Instalime të brendshme elektrike, ndriçim, panele komandimi, lidhje elektrike brenda godinës	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Referuar zërave të preventivit për Punime për matje, nivelime dhe kontroll topografik gjatë rehabilitimit të objektit	A	0-20 milion

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licensen e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisori

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit profili Strukturist** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.
- **Ing. Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Mjedisit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “*Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qenë se këto punime janë të një rendësie të vecantë dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në rikonstrukcion dhe vendosje të pompave të Hidrovorit të qytetit, për të shmangur përmbytjet e njëpasnjëshme që vijnë si pasojë mungesës dhe daljes jashtë përdorimi të pompave ekzistuese, vlerësohet e nevojshme që të kerkohen specialist të fushave inxhinierike më sipër.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
- a) Kontratë pune e vlefshme;
 - b) Diplomë.

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë që ka të bëjë me Funizim Vendosje sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga rendësia e objektit të kontratës, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Profesioni/Kualifikimi	Numri i të punësuarve
1. Teknik të mesëm ndërtimi	1
2. Teknik/Specialist të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	1
3. Hidraulik	1
4. Elektracist	2
5. Mekanik	2
6. Hekurkthyes	1
7. Eskavatorist	3
8. Saldator me Tig	2
9. Saldator	1
10. Murator/Suvatues	1
11. Bojaxhi	1

2.3.4/1 Për punonjësit eskavatorist/ manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët/automakinistët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune) , ne liste pagese 3 (tre) muajt e fundit si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik, të certifikuar nga prodhuesi / institucione të autorizuar për monitorimin e gazit dhe të vajit të transformatorëve të fuqisë, si dhe në instalimin dhe komisionimin e sistemit në terren pa e shkeputur nga puna.
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik ose Mekatronik i Certifikuar per kamera termografike
- 1 (nje) Inxhinier me Certificate trajnimi per sistemet e leshime automatike (SCADA) dhe per PLC
- 2 (dy) Saldator te Certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1:2017

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet dhe duhet te paraqese:

- Kontratat individuale te punes (të vlefshme).
- Diplomë/Certifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa që Operatorët Ekonomikë të kenë në stafin e tyre minimalisht një (1) inxhinier elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose nga institucione të autorizuar ka për qëllim të sigurojë që monitorimi i gazit dhe vajit të transformatorëve të fuqisë, si dhe instalimi dhe komisionimi i sistemit në terren, të kryhen në përputhje me standardet teknike dhe procedurat e sigurisë. Monitorimi i gazit të vajit të transformatoreve është një proces teper i rendesishëm pasi duke bërë analizat e vajit në mënyrë periodike operatori është në gjendje të kuptuar gjendjen teknike të transformatorit, dhe mund të marrë masa teknike parandaluese përpara sesa të shkaktohen demtime të përkuperueshme. Demtime të cilat mund të ndërpresin punën e stacionit të pompimit gjatë punës dhe duke kërkuar zëvendësimin komplet të transformatorit për ta rivendosur në funksionim stacionin e pompimit. Sa më sipër AK kërkon një inxhinier të certifikuar në nivelin e duhur profesional për të bërë funksionin e sistemeve që do të furnizohen. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejt për drejt me aftësinë profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë e OE për aftësitë teknike. Ky kriter i mundëson Autoritetit Kontraktor të vlerësojë kapacitetin teknik dhe profesional të Operatorit Ekonomik, duke siguruar që kontrata do të përmbushet me sukses dhe në mënyrë të sigurt. Ai është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke garantuar besueshmërinë dhe profesionalizmin e OE-së në ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për Inxhinier Elektrik ose Mekatronik i Certifikuar për kamera termografike:

Në rastin e një hidrovorri, i cili përbën një objekt të rëndësishëm së veçantë për largimin e ujit, parandalimin e përmbytjeve dhe funksione të tjera jetike të infrastrukturës, siguria dhe besueshmëria e sistemit elektrik janë elemente thelbësore për funksionimin e pandërprerë dhe afatgjatë të tij. Në këtë kuadër, prania e një inxhinieri të trajnuar dhe të specializuar në termografi gjatë vënies në punë për herë të parë të sistemit elektrik është e domosdoshme dhe e justifikuar në mënyrë të plotë, si nga pikëpamja teknike ashtu edhe ajo e sigurisë.

Termografia, si metodë moderne diagnostikuese, mundëson zbulimin e hershëm të defekteve të fshehura në komponentët elektrikë përmes analizës së shpërndarjes së temperaturës. Ajo evidenton mbixehjet anormale që zakonisht paraprijnë dështimet elektrike ose mekanike, duke ofruar mundësinë për ndërhyrje parandaluese përpara se të ndodhin dëmtime serioze. Një sistem elektrik i një hidrovorri, i cili përfshin transformatorin, thikat ndarëse, panelet shpërndarëse dhe të komandimit, si dhe pompën zhytëse, është i ngarkuar me flukse të larta energjie, punon në kushte mjedisore me lagështi

të lartë dhe kërkon disipim termik të qëndrueshëm. Në këto kushte, termografia bëhet një instrument i pazëvendësueshëm për garantimin e sigurisë dhe efikasitetit të sistemit.

Një inxhinier i trajnuar në termografi zotëron njohuritë dhe përvojën e nevojshme për të interpretuar me saktësi rezultatet e matjeve termike, duke marrë parasysh faktorë si temperatura e ambientit, lagështia, reflektimi, përçueshmëria e materialeve dhe emetueshmëria e sipërfaqeve. Vetëm një profesionist i trajnuar është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të saktë nëse një mbinxehje është rezultat i ngarkesës elektrike, i rezistencës së kontaktit apo i ndonjë defekti të brendshëm në pajisje. Një interpretim i gabuar i të dhënave termografike mund të çojë në vendime të pasakta, të cilat jo vetëm që nuk e shmangin rrezikun, por mund ta shtojnë atë.

Faza e vënies në punë për herë të parë është momenti më kritik i gjithë procesit të ndërtimit të sistemit elektrik, pasi në këtë fazë çdo komponent përballet për herë të parë me ngarkesën reale të punës. Është pikërisht në këtë fazë që dalin në pah të gjitha problematikat që nuk mund të zbulohen vetëm me inspektim vizual apo me matje elektrike konvencionale. Një inxhinier i trajnuar në termografi, përmes analizës termike të transformatorit, thikave ndarëse, paneleve shpërndarëse dhe paneleve të komandimit, është në gjendje të identifikojë menjëherë pika të nxehta që tregojnë lidhje të dobëta elektrike, shtrëngime të pamjaftueshme të terminaleve, kontakt të dobët në shina, apo ngarkesa të pabarabarta ndërmjet fazave. Këto fenomene janë një ndër shkaqet kryesore të defekteve në sistemet elektrike dhe, në mungesë të një kontrolli termografik, mund të çojnë në shkrirje kontakti, qark të shkurtër, djegie të pajisjeve ose madje edhe zjarre.

Termografia gjatë vënies në punë është gjithashtu e domosdoshme për verifikimin e disipimit termik të transformatorit, kontrollin e temperaturës në pikën e lidhjes së kabllave të tensionit të ulët dhe të lartë, si dhe për analizimin e ngarkesës së pompave zhytëse gjatë funksionimit. Një pompë zhytëse që punon në kushte jo optimale (p.sh. me ngarkesë të pabarabartë, ose me defekt në kabllon e furnizimit) do të reflektojë menjëherë në temperaturën e rrymës që shkon drejt saj. Kjo bën të mundur që defekti të identifikohet përpara se të shkaktojë djegien e motorit apo prishjen e sistemit të komandimit. Përveç kësaj, analiza termografike ndihmon në verifikimin e baraspeshës ndërmjet fazave, identifikimin e çrregullimeve në sistemin e shpërndarjes së ngarkesës dhe evidentimin e çdo elementi që nuk disponon nxehtësinë në mënyrë të barabartë.

Në një hidrovor, çdo defekt elektrik përbën një rrezik të drejtpërdrejtë jo vetëm për pajisjet, por edhe për personelin dhe mjedisin përreth. Kombinimi i ujit me energjinë elektrike kërkon masa maksimale sigurie, pasi rreziku i qarkut të shkurtër, zjarrit apo goditjes elektrike është shumë i lartë. Një kontroll i imtësishëm termografik kryer nga një inxhinier i trajnuar ndihmon në eliminimin e këtyre rreziqeve, duke siguruar që çdo komponent funksionon brenda kufijve termikë të parashikuar nga prodhuesi dhe standardet ndërkombëtare.

Në rastin e objekteve të rëndësisë së veçantë, siç është një hidrovor, përfshirja e një raporti termografik nga një inxhinier i trajnuar është jo vetëm praktikë e mirë inxhinierike, por shpesh edhe kërkesë ligjore për dorëzim dhe kolaudim teknik.

Në përfundim, praninë e një inxhinieri të trajnuar në termografi gjatë vënies në punë të një sistemi elektrik për hidrovor nuk duhet ta konsiderojmë si një shtesë të panevojshme, por si një element thelbësor të sigurisë, cilësisë dhe jetëgjatësisë së investimit. Ai siguron që sistemi elektrik të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, pa mbinxehje dhe pa defekte të fshehura, duke parandaluar aksidente, dëmtime dhe ndërprerje të shërbimit. Në këtë

mënyrë, përfshirja e tij garanton jo vetëm zbatimin korrekt të projektit teknik, por edhe mbrojtjen e interesit publik dhe të sigurisë së vetë objektit.

Kërkesa për Inxhinier me Certificate trajnimi per sistemet e leshime automatike (SCADA) dhe per PLC:

Në një hidrovor, përveç pjesës energjetike dhe elektrike të sistemit, një rëndësi të veçantë ka edhe pjesa e kontrollit dhe automatizimit, e cila siguron funksionimin e saktë, të qëndrueshëm dhe të sigurt të gjithë procesit. Për këtë arsye, në çdo projekt të tillë është e domosdoshme prania e një inxhinieri të certifikuar dhe të specializuar në PLC dhe SCADA, pasi këto sisteme janë “truri” i funksionimit të hidrovorit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e tij.

Në një hidrovor modern, procesi i kontrollit nuk kufizohet vetëm në ndezjen dhe fikjen e pompave, por përfshin një sërë parametrash që duhet të monitorohen dhe kontrollohen në mënyrë automatike dhe të ndërvarur. Këtu hyjnë kontrolli i nivelit të ujit në dhomën e pompës dhe në kanalin hyrës, menaxhimi i mbrojtjes së pompave nga punimi në të thatë, mbrojtja ndaj mbingarkesës dhe mbrojtja termike, si dhe llogjika të ndryshme të operimit për të garantuar që sistemi të punojë gjithmonë në mënyrë optimale dhe të sigurt. Të gjitha këto kërkojnë projektim të kujdesshëm dhe programim të saktë të PLC-së, si dhe ndërtimin e një ndërfaqeje operimi që i lejon operatorit të ketë kontroll dhe mbikëqyrje të plotë mbi të gjitha proceset.

Një inxhinier i certifikuar në PLC dhe SCADA është i pajisur me njohuritë e nevojshme për të ndërtuar logjikën e saktë të funksionimit të sistemit, duke respektuar kushtet teknologjike dhe rregullat e sigurisë. Ai di të përcaktojë se në çfarë niveli uji pompat duhet të aktivizohen ose çaktivizohen, si të reagojë sistemi në rast defekti elektrik apo hidraulik, dhe si të sigurohet që asnjë pompë të mos punojë në kushte të dëmshme për vetveten apo për sistemin. Për më tepër, inxhinieri i automatizimit garanton që të gjitha sinjalet e alarmit, paralajmërimet dhe ndërhyrjet automatike të jenë të sinkronizuara dhe të mbrojtura nga gabime logjike që mund të shkaktojnë ndërprerje ose dëmtime.

Një aspekt po aq i rëndësishëm është siguria ndaj gabimeve njerëzore. Një ndërfaqe operimi e projektuar nga një inxhinier i specializuar krijohet në mënyrë të tillë që të jetë e qartë, intuitive dhe e mbrojtur ndaj komandave të pasakta. Operatorët mund të monitorojnë në kohë reale nivelet e ujit, statusin e pompave, temperaturën e motorëve, tensionet dhe rrymën, si dhe çdo alarm që lidhet me funksionimin e sistemit. Një ndërfaqe e mirëprojektuar ul ndjeshëm rrezikun e ndërhyrjeve të gabuara dhe siguron që çdo komandë të kryhet vetëm në kushtet e duhura të sigurisë.

Përveç aspektit të sigurisë, një sistem PLC dhe SCADA i projektuar nga një profesionist i certifikuar rrit ndjeshëm efikasitetin energjetik dhe operacional të hidrovorit. Përmes programimit inteligjent, pompat mund të alternohen në punë në mënyrë të balancuar, duke shmangur konsum të tepërt ose ngarkesë të pabarabartë ndërmjet tyre. Po ashtu, sistemet moderne mund të përfshijnë edhe funksione të avancuara si komandimi automatik me varësi nga niveli, presioni apo prurja, gjë që optimizon përdorimin e energjisë dhe rrit jetëgjatësinë e pajisjeve.

Në objektet e rëndësishme të veçantë, siç është një hidrovor, kërkohet që çdo ndërhyrje automatike apo mbrojtëse të jetë e testuar dhe e verifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë industriale. Një inxhinier i certifikuar në këto fusha jo vetëm që garanton që sistemi të jetë funksional, por edhe që të përmbushë kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare të projektimit dhe kolaudit.

Në përfundim, një hidrovor nuk mund të konsiderohet teknikisht i përfunduar dhe i sigurt për operim nëse nuk është projektuar, programuar dhe vënë në punë nga një inxhinier i kualifikuar në PLC dhe SCADA, i cili garanton që të gjitha elementet e kontrollit dhe mbrojtjes të funksionojnë në mënyrë të saktë dhe të harmonizuar. Vetëm një specialist i tillë mund të sigurojë që sistemi të reagojë në mënyrë automatike ndaj çdo situatë, të mbrojë pajisjet nga dëmtimi, të shmangë ndërhyrjet e gabuara nga operatori dhe të sigurojë që hidrovorri të punojë me efikasitet maksimal, siguri të plotë dhe jetëgjatësi të garantuar.

2.3.7 Një punësim minimalisht prej **40 (dyzetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi **per 3 muajt e fundit** te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **3 muajt** e fundit te deklaruar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej **31 723 orë pune punëtori +pune makineri**, për të cilat nevojiten 30 punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën **40 (dyzetë) punonjës**.

			Ore totale punetori	25259	Ore totale makineri	6464
Ore pune ne total per kryerjen e punimeve Referuar Normatives sipas Manualit te Ndertimit		31723				

Total I oreve te punes per kryerjen e punimeve sipas grafikut, Muaj* 22 dite pune * 8 ore	6	1056		
Numri total i fuqise punetore per kryerjen e punimeve		30	30 Puntor	

2.3.8.Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	Pompa sipas projektit dhe specifikimeve teknike	CE, ISO 9001, 14001, 45001 Pompë Zhytëse me Helike me fluks aksial (submersible axialflow propeller pumps), e përshtatshme për stacione pompimi për mbrojtjen nga përmbytjet dhe vaditje ku nevojiten prurje të mëdha uji. Pompa të jetë e pajisur me kllapë ngritëse që lehtëson transportin dhe instalimin e lehtë në vend, si dhe fiksimin e kabllit mbi hyrjen e kabllit në trupin e pompës. Pompa të ketë izolim të dyfishtë të aksit (double shaft seal) që të mundësojë zëvendësimin e izoluesit (shaft seal) lehtësisht në vend pa patur nevojë për mjete speciale. Pompa të ketë lidhësin e kabullit që në rast nevojë kabulli të shkëputet nga pompa pa patur nevojë që të hiqet pjesa e sipërme e motorit. Për të rritur eficientë, pompat duhet të kenë optimizues të turbulencës midis pompës dhe tubit të kolonës ku do instalohet pompa (Turbulence Optimizer). Pompa të ketë hapje anësore që të aksesohet tek lidhjet e kablove të fuqisë	

		dhe sensorëve pa patur nevojë të hiqet kapaku i pompës dhe fiksuesi i kabullit. Kurba e Punës duhet të përfshijë këto prurje dhe presione: Prurja = 5350 lit/s ; Presioni H = 6,0 metra ; Pika e Punës : Prurja = 5500 lit/s ; Presioni H = 5,5 metra ; (Shaft Power = 366 kW) ; NPSH=7,6 m Prurja = 6100 lit/s ; Presioni H = 3,0 metra ; Efienca e Pompës në Pikën e Punës > 80% ; Efienca Pompë + Motor në Pikën e Punës > 74% ; Fuqia e Motorit: P1 = 432,4 kW ; P2 = 400 kW ; Tipi i Motorit: Squirrel cage induction motor ; Standarti : NEMA - Design B ; Numri i Poleve të motorit : 14 pole ; Shpejtësia e rrotullimeve: 410 rpm ; Tensioni : 3 x 400 V ; Rryma në Pikën e Punës: 804,3 A ; Mënyra e Startimit : Me INVERTER (VFD) ; Numri maksimal i ndezjeve/orë : 10 herë ; Mbrojtje e motorit : Bi-metal/PT-100Ω ; Mbrojtje termike e kushinetave të sipërme dhe të poshtme: PT-100Ω ; Sensor lageshtie në motor: tipi Switch ; Sensor lagështie në kutinë e terminaleve: tipi Switch ; Pompa të ketë Sensor Uji në Vaj ; Pompa të ketë Sensor Vibrimi ; Pompa e kompletuar me	
--	--	---	--

		kabull fuqie dhe sinjali të sensorëve ; Tipi i kabullit të fuqisë : PNCTR-S ; Gjatësia e kabullit : 10 ml ; Hermetizimi sipas (IEC 34-5) : IP68 ; Izolimi sipas (IEC 85) : F ; Materiali i Trupit të Pompës : Gizë sipas GC 250 [EN-GJL-250] ; Materiali i Helikës : Celik Inox sipas SSC 13 [G-X6CrNi189-1.4308] ; Materiali i Aksit : Celik Inox STS 410 [X10Cr13] ; Kendi Helikave: 19° (grade) Tipi i Helikës : Propeller me fletë/tehe ; Numri i fletëve : 4 Diametri i mbetjeve të ngurta që mund të largojë : 225 mm ; Aprovime : CE,EAC ; Presioni maksimal i operimit : 10 bar ; Lartësia e Pompës : 4110 mm ; Pesha Neto : 8380 kg	
2	Panel sipas projektit dhe specifikimeve teknike	Panel Komandimi të Pompave në Stacion I kompletuar me Konvertitor Frekuence (INVERTER) për secilën pompë në përputhje me Standardet IEC: IEC 61439 për Pajisjet dhe Asemblimet e Tensionit të Ulët dhe IEC 60947 për Komponentët e Kontrollit. Paneli I Komandimit i projektuar dhe konfiguruar sipas MCC (motor control center) ; Paneli I Komandimit I kompletuar me Njësine Qëndrore të Monitorimit dhe Kontrollit që mundëson komandimin e 1-6 Pompave si një grup i vetëm pompash në funksion kaskadë. Njësia Qëndrore e Kontrollit të jetë e pajisur me ekran ku të shfaqen të gjithë sinjalet dhe statusi i komplet sistemit të Pompave dhe Inverterave. Të	

		ofrojë këto Hyrje/Dalje (Inputs/Outputs): 3 hyrje sinjali dixhital (digital inputs) ; 3 hyrje sinjali analog (analog inputs) nga sensorët (0-20 mA/4-20 mA) ose (0-10 V) ; 2 dalje Re-Le sinjali dixhital 240 VAC, 2 A ; portë komunikimi (RS-485) ; portë për lidhjen Ethernet (VNC) ; Komunikim me anë të moduleve shitesë me Sistemin Qëndror të Monitorimit dhe Kontrollit sipas Protokolleve Modbus, Profibus, Profinet, Ethernet IP. Lëshuesi i Butë (Soft Starter) për pompat për kategorinë e ngarkesave AC- 3A dhe AC-53A. Paneli i Komandimit i kompletuar me PLC për Monitorimin dhe Kontrollin e Pompave dhe komunikimin e të dhënave. Hermetizimi : IP55 ; Kompletuar me Mbrojtjen nga Mbingarkesa, Tensioni, Qarku i Shkurtër, Mungesa e Tokëzimit	
--	--	---	--

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që është prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.9 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi sipas zerave të Preventivit për Furnizim Makineri-Paisje: Cila Hyrje+Dalje SF6 me mikroprocesore TM20kV ; Cila Mbrojtje TM 20kV, Cele matje me tarfo rryme+tensioni me mikroprocesor TM20kV; Transformator fuqie me vaj

20/6/0.4 kv-1250kVA (binjake) ; Elektropompa Zhytese ; Panele T.U 4kV per leshimin Automatik/Manual. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon,e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj). Autorizimi i prodhuesit duhet te jete i perkthyer dhe noterizuar ne gjuhen Shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mallrat e ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.10 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat objekt prokurimi sipas zerave te Preventivit per Furnizim Makineri-Paisje: Cela Hyrje+Dalje SF6 me mikroprocesore TM20kV ; Cela Mbrojtje TM 20kV, Cele matje me tarfo rryme+tensioni me mikroprocesor TM20kV; Transformator fuqie me vaj 20/6/0.4 kv-1250kVA (binjake) ; Elektropompa Zhytese në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike. Në katalog, të markohen në menyërë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Shenim: Në Specifikimet Teknike, kudo ku përshkruhet markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, lejohet te ofertohe ekuivalent.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetin e ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e markimit CE/SSH, të cilat vërtetojnë se prodhuesi i ÇELAVE dhe TRANSFORMATORIT te fuqise është në përputhje me kërkesat e sigurisë sipas standardeve Europiane dhe Shqiptare:

SSH EN 60947-2:2017
SSH EN 61000-6-1:2019
SSH EN 61000-3-3:2013
SSH EN 61000-6-3:2021 + A2:2024
SSH EN 61000-3-2:2019 + A2:2024

Argumentim: Ky kriter është i përshtatshëm dhe proporcional me objektin e kontratës dhe zbatohet në përputhje me nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ai siguron që produktet e ofruara në procedurën e prokurimit të jenë të prodhuara në përputhje me kërkesat dhe standardet përkatëse.

Vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së mallrave të prokuruar. Markimi CE shërben si dëshmi e qartë se pajisjet janë të përshtatshme për përdorim në tregun Evropian dhe se ato janë prodhuar dhe testuar sipas standardeve të njohura për cilësi dhe siguri.

Në veçanti, kërkesa për përputhshmëri me standardet SSH EN 60947-2:2017, SSH EN 61000-6-1:2019, SSH EN 61000-3-3:2013, SSH EN 61000-6-3:2021 + A2:2024, SSH EN 61000-3-2:2019 + A2:2024, garanton mbrojtje nga ndërhyrjet elektromagnetike, një element kyç për impiantet me tension të lartë. Ky kriter ofron autoritetit kontraktor sigurinë se mallrat e ofruara nuk do të jenë me cilësi të ulët, nuk do të jenë të rrezikshme dhe nuk do të ndikojnë negativisht në funksionimin e pajisjeve të tjera të centralit.

2.3.12 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Emri i mjetit	Sasi	Njesi	Statusi
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 6-10 ton	2	copë	Në pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1	copë	Në pronësi ose me qera
Ekskavator 0.25 m3	1	copë	Në pronësi ose me qera
Tokmak Elektrik	1	copë	Në pronësi ose me qera
Betoniëre 500 liter	1	copë	Në pronësi ose me qera
Vibrator thellesie	1	copë	Në pronësi ose me qera

Vinc kulle 0.5-1 ton	1	copë	Në pronësi ose me qera
Trapano elektrike	1	copë	Në pronësi ose me qera
Gazogjen 1 m3/ore	1	copë	Në pronësi ose me qera
Autovinç	1	copë	Në pronësi ose me qera
Grejder	1	copë	Në pronësi ose me qera
Aparat Argoni	1	copë	Në pronësi ose me qera
Trapano elektrike	1	copë	Në pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	1	copë	Në pronësi ose me qera
Elektrokompresor	1	copë	Në pronësi ose me qera
Fadrome	1	copë	Në pronësi ose me qera
Ponton (drage lundruese)	1	copë	Në pronësi ose me qera
Makineri per prerje dhe kthim hekuri ndertimi	1	copë	Në pronësi ose me qera
Autobot uji	1	copë	Në pronësi ose me qera
Rrul hekur-hekur deri 4 ton	1	copë	Në pronësi ose me qera
Automjet teknologjik e pajisur me pompe vakumi per thithje llumi .	1	copë	Në pronësi ose me qera
Gjenerator / Motogjenerator	1	copë	Në pronësi ose me qera
Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice/	1	copë	Në pronësi ose me qera
Motopompe uji	1	copë	Në pronësi ose me qera
Matrapik	1	copë	Në pronësi ose me qera
Pajisje me ultratinguj për detektimin e defekteve për provat pa shkatërrim të saldimeve për strukturat metalike për trashësi deri në 60mm	1	copë	Në pronësi ose me qera
Mates Tokezimi me certifikate kalibrimi	1	copë	Në pronësi ose me qera
Multimeter Digital me certifikate kalibrimi	1	copë	Në pronësi ose me qera
Dare multimeter me certifikate kalibrimi	1	copë	Në pronësi ose me qera
Kamera Termike	1	copë	Në pronësi ose me qera
Kalibrues 4-20mA	1	copë	Në pronësi ose me qera

Aparate Saldimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe TIG 410 A	1	copë	Në pronësi ose me qera
Aparate Sladimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe MIG/MAG 500 A	1	copë	Në pronësi ose me qera
Jelekë	40	copë	Në pronësi
Kokore	40	copë	Në pronësi
Kuti ndihme e shpejtë	5	copë	Në pronësi
Fikëse zjarri të lëvizshme	5	copë	Në pronësi

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);**
- b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);**
- c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)**
- d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;**
- e) Liçencë transporti;**
- f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;**
- g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- a) Kontrata e qerasë**
- b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);**
- c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)**
- d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;**
- e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);**
- f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;**
- g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij**

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)

- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët

ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH **ISO 45001:2018** e përditësuar, (**SSH EN ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese ISO-t në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e

përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT